



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERËT PUBLIKË

Nr. \_\_\_\_\_ prot.

Tiranë, më 27.4.2021

**Lënda:** Parashtrime të Komisionerit Publik, në seancën gjyqësore të datës 27.4.2021, para trupit gjykues, të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në çështjen ankim kundër vendimit nr. 183, datë 19.7.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit z. Petrit Çano

**Baza ligjore:** Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”

**Drejtuar:** Kolegjit të Posaçëm të Apelit

Të nderuar anëtarë të trupit gjykues,

Në zbatim të nenit 55, pika 7 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë, në datën 18.9.2019, është njoftuar vendimi nr. 183, datë 19.7.2019, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, z. Petrit Çano, me detyrë prokuror/Drejtues i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Krujë.

Komisioneri Publik, në mbështetje të nenit C, pika 2, nenit F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës, dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, pas analizës dhe vlerësimit të provave dhe rrethanave të dala nga hetimi administrativ i Komisionit, çmon se vendimi nr. 183/2019, përmban shkaqe ligjore të tilla që duhet t’i nënshtrohen juridiksionit kontrollues/rivlerësues të Kolegjit të Posaçëm të Apelit (në vijim referuar Kolegji), pasi ky vendim shfaq mangësi në drejtim të hetimit administrativ të ndërmarrë nga ana e Komisionit.

Për efekt të këtij gjykimi, Komisioneri Publik parashtron në vijim mungesën e hetimit mbi rrethana të tilla dhe fakte ligjore, si:

- (i) Procedura e kontrollit të figurës rezulton e paplotë, pasi raporti për kontrollin e figurës që mban datën \*\*\*.11.2017, në referencë të nenit 39 të ligjit nr. 84/2016, është përpiluar në mungesë të informacionit të një prej 3 institucioneve verifikuese.

- (ii) Gjendja e mundshme e konfliktit të interesit midis subjektit të rivlerësimit dhe funksionit të magjistratit/prokuratorit, në drejtim të përfitimit të një trajtimi preferencial, në kuptim të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” (të ndryshuar), në raport me dy kontrata për blerje pasurie të paluajtshme. Përfundimet e arritura nga kontrolli i këtyre dy pasurive do të japin përgjigje edhe në drejtim të fiktivitetit në dukje të veprimeve
- (iii) Mungesë hetimi lidhur me burimet e ligjshme të të ardhurave që kanë shërbyer për krijimin e dy pasurive të paluajtshme, si dhe mbi pamjaftueshmërinë për të mbuluar me burime të ligjshme shpenzimet dhe kursimet e deklaruar ndërsa vite.
- (iv) Nevoja e hetimit për kriterin e aftësive profesionale, në ushtrimin e funksionit si drejtues i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Krujë.

Komisioneri Publik, bazuar në specifikat e rrethanave të dala nga aktet e administruara nga Komisioni gjatë hetimit administrativ dhe rrethanave ligjore të konstatuara gjatë kohës pas depozitimit të ankimit në Kolegj, në kuptim të qëllimit të shpallur në nenin 179/b, pika 1 e Kushtetutës dhe të zbatimit të duhur të ligjit, vlerëson se rezultatet e hetimit nga ana e Kolegjit, mbi këto rrethana të ndërthurura me njëra-tjetrën, që lidhen me të tria kriteret e rivlerësimit, eventualisht do të provonin nëse *veprimet apo mosveprimet* e subjektit të rivlerësimit kanë cenuar rregullat etike profesionale, figurën e magjistratit apo nëse subjekti i rivlerësimit ka pasur ose jo burime të ligjshme të të ardhurave dhe, në vlerësimin tërësor të procedurave, do të mund të vendosej mbi vlerësimin përfundimtar për konfirmimin ose jo në detyrë të subjektit të rivlerësimit.

Për sa më sipër, duke i qëndruar të gjitha shkaqet të parashtruara në ankimin e Komisionerit Publik kundër vendimit nr. 183, datë 19.7.2019, në mënyrë të përmbledhur, parashtrojmë arsyetimin për rrethanat dhe faktet ligjore që kanë nevojë për hetim të mëtejshëm:

## **I. Për kontrollin e kriterit të figurës**

1. Sikundër është parashtruar në shkaqet e ankimit të Komisionerit Publik, nga aktet në dosje, ka rezultuar se Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë \*\*\*.11.2017, ka dërguar raportin<sup>1</sup> mbi kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit, z. Petrit Çano, me anë të cilit konstatohet: *përshtatshmëria për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit*. Ky raport i grupit të punës, sikurse evidentohet në të njëjtën shkresë, është *përpiluar pa përgjigjen e një prej 3 institucioneve verifikuese*.

2. Komisioneri Publik vlerëson se, në respektim të parashikimeve ligjore në ligjin nr. 84/2016, përbërjes dhe detyrave të grupit të punës<sup>2</sup> në hartimin e Raportit, në referencë të hetimit gjyqësor, është i nevojshëm:

2.1 përditësimi i Raportit të datës \*\*\*.11.2017, me qëllim administrimin e informacionit nga institucioni verifikues, të dhënat e të cilit nuk janë marrë në shqyrtim gjatë hartimit të Raportit të parë.

## **II. Për kontrollin e kriterit të pasurisë**

3. *Gjendja e mundshme e konfliktit të interesit në raport me dy kontrata blerje pasurie të paluajtshme. Burimet e ligjshme të të ardhurave që kanë shërbyer për krijimin e këtyre dy pasurive*

<sup>1</sup> Deklasifikuar plotësisht me vendim të KDZH-së nr. \*\*\*, datë \*\*\*.9.2018.

<sup>2</sup> Shihni nenin 36, pikat 2 dhe 3, nenin 37, 38 dhe 39 të ligjit nr. 84/2016.

*të paluajtshme. Përfundimet e arritura nga kontrolli i këtyre dy pasurive do të japin përgjigje edhe në drejtim të fiktivitetit në dukje të veprimeve.*

4. Nga aktet në dosje, ashtu sikurse është trajtuar dhe në shkaqet e ankimit, rezulton se subjekti i rivlerësimit, z. Çano, ka të regjistruar në regjistrin e pasurive të paluajtshme pasurinë me nr. \*\*\*/\*\*+\*\*\_\*\*, vol. \*\*, faqe \*\*, zona kadastrale \*\*, lloji pasurisë: Apartament me sipërfaqe 102.6 m<sup>2</sup>, me vendndodhje rruga “\*\*\*\* \*\*’\*\*\*\*”, Tiranë (referuar në vijim “*Apartament 102 m<sup>2</sup>*”). Personi i lidhur, vajza e subjektit të rivlerësimit, znj. \*\*. \*\*, ka të regjistruar në regjistrin e pasurive të paluajtshme pasurinë me nr. \*\*\*/\*\*+\*\*\_\*\*, vol. \*\*, faqe \*\*, zona kadastrale \*\*, lloji pasurisë: Apartament me sipërfaqe 63 m<sup>2</sup>, me vendndodhje rruga “\*\*\*\* \*\*”, Tiranë (referuar në vijim “*Apartament 63 m<sup>2</sup>*”).

5. Komisioneri Publik, për pasurinë “*Apartament 102 m<sup>2</sup>*”, vlerëson se Komisioni nuk ka kryer një hetim administrativ të gjithanshëm e shterues, në drejtim të verifikimit: (i) të konfliktit të mundshëm të interesit; (ii) veprimeve në dukje fiktive dhe (iii) vlerësimit të burimit të ligjshëm të të ardhurave të deklaruara.

(i) *Konflikti i mundshëm i interesit në drejtim të përfitimit të trajtimit preferencial*

5.1 Referuar kontratës së shitblerjes, së datës \*\*.12.2011, pasuria “*Apartament banimi 102 m<sup>2</sup>*”, ka një çmim total prej 7,500,000 lekësh, ndërkohë çmimi i tregut të lirë, i cili shërben për llogaritje të tatimit sipas udhëzimit nr. 9/2008<sup>3</sup>, është në vlerën totale prej 17,955,000 lekësh. Komisioni, në vlerësimin e rrethanave që kanë çuar në këtë diferencë të konsiderueshme, rreth 60% më lirë, duhej të hetonte në drejtim të konfliktit të interesit, duke e shtrirë verifikimin në të gjithë periudhën e ushtrimit të detyrës nga ana e subjektit të rivlerësimit, z. Çano, dhe jo duke e kufizuar atë vetëm në periudhën<sup>4</sup> kur ka ndodhur transaksioni i shitblerjes. Hetimi në këtë drejtim do të shërbente për të verifikuar në rast se detyra e subjektit të rivlerësimit ka ndikuar për favor, premtim apo trajtim preferencial.

(ii) *Veprimet në dukje fiktive*

5.2 Diferenca midis çmimit të shitjes së kësaj pasurie, sipas udhëzimit nr. 9/2008, dhe çmimit të përcaktuar në kontratë midis palëve, rreth 60% më lirë, duhej të shërbente si indicie për Komisionin për të hetuar në mënyrë më të plotë në drejtim të veprimeve fiktive në dukje, me qëllim për të mbuluar pamundësinë financiare nga burime të ligjshme të subjektit të rivlerësimit, për të blerë këtë pasuri me çmimin real të saj. Për më tepër që subjekti është shprehur se dhe pagesa e rivlerësimit të pasurisë<sup>5</sup>, në muajin korrik 2011, është kryer po nga shitësi, z. \*\*. \*\*, çka ul akoma më shumë vlerën reale të përfutur nga ky i fundit (shitësi) për apartamentin me sip. 102 m<sup>2</sup>.

(iii) *Vlerësimi i burimit të ligjshëm i të ardhurave të deklaruara*

5.3 Në lidhje me burimin e të ardhurave të deklaruara, nga aktiviteti privat i personit të lidhur, znj. \*\*. \*\*, bashkëshortja e subjektit, ka rezultuar se Drejtoria Rajonale Tatimore Fier, me

<sup>3</sup> Udhëzimi nr. 9, datë 26.2.2008, “Për tatimin e kalimit të së drejtës së pronësisë së paluajtshme”, i ndryshuar.

<sup>4</sup> Subjekti i rivlerësimit, në përgjigjet e datës 29.10.2018, ka paraqitur vërtetimin nr. \*\*\* prot., datë \*\*.10.2018, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Vlorë.

<sup>5</sup> Shihni përgjigjet e subjektit të rivlerësimit të datës 29.10.2018.

shkresën e datës \*\*\*.2.2019, ashtu sikurse rezulton edhe në korrespondencën me ILDKPKI-në, ka konfirmuar se subjekti “\*\*\*” sh.p.k. ka detyrime të papaguara “tatim fitimi i thjeshtuar”, në shumën 110.000 lekë, për të cilën nuk konfirmohet se kujt viti i takon. Në këtë rast, hetimi i mëtejshëm mbi identifikimin e vitit përkatës për të cilin nuk janë shlyer detyrimet tatimore, ndikon në konsiderimin ose jo të të ardhurave të deklaruara si të ardhura të ligjshme, në kuptim të nenit D të aneksit të Kushtetutës.

**6.** Komisioneri Publik, për pasurinë “*Apartament 63 m<sup>2</sup>*”, vlerëson se Komisioni nuk ka kryer një hetim administrativ të gjithanshëm e shterues, në drejtim të verifikimit të: (i) konfliktit të mundshëm të interesit; (ii) pagesës së shumës 1.023.335 lekë, e rezultuar nga aplikimi pranë Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë; (iii) veprimeve në dukje fiktive; (iv) vlerësimit të burimit të ligjshëm të të ardhurave të deklaruara nga kontrata e shitjes, e datës \*\*\*.10.2010, në shumën 1.400.000 lekë.

(i) *Konflikti i mundshëm i interesit në drejtim të përfitimit të trajtimit preferencial*

6.1 Referuar kontratës së shitblerjes, e datës \*\*\*.7.2014, pasuria “*Apartament banimi 63 m<sup>2</sup>*”, ka një çmim prej 7.431.660 lekë<sup>6</sup>, ndërkohë çmimi i tregut të lirë, i cili shërben për llogaritje të tatimit sipas udhëzimit nr. 9/2008, është në vlerën totale prej 12.033.000 lekë. Komisioni, në vlerësimin e rrethanave që kanë çuar në këtë diferencë të konsiderueshme, rreth 40% më lirë, duhej të hetonte në drejtim të konfliktit të interesit. Kjo diferencë e dukshme në çmim duhej të trajtohej, sikurse pjesërisht është bërë për pasurinë “*Apartament banimi 102 m<sup>2</sup>*”, në drejtim të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit, z. Çano, me palën shitëse, në këndvështrim të favoreve, premtimit apo trajtimit preferencial që do të kishte passjellë çmimin e ulët.

(ii) *Pagesa e shumës 1.023.335 lekë në aplikimin pranë ZVRPP-së Tiranë*

6.2 Nga dokumentet shoqëruese për pasurinë, dërguar nga ZVRPP-ja Tiranë, evidentohet edhe kërkesa e datës \*\*\*.7.2014, më kërkuese znj. \*\*\*. \*\*\*, në të cilën pasqyrohet pagesa totale për aplikimin në vlerën 1.023.355 lekë, ku përfshihet edhe tatimi mbi kalimin e pronësisë. Komisioni, nuk ka hetuar në drejtim të paguesit të kësaj shume, rrethanë e cila do të ndikonte në mënyrë të drejtpërdrejtë në analizën financiare për vitin 2014, për vlerësimin e mjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme që kanë shërbyer për kryerjen e pagesave deri në datën \*\*\*.7.2014. Sipas dispozitave nënligjore që lidhen me pagesat e tatimit mbi kalimin e së drejtës së pronësisë, detyrimi për këtë pagesë qëndron te shitësi, ndërkohë që ky rregullim ligjor nuk ka kufizuar marrëveshje të palëve, sipas të cilës ky detyrim është paguar edhe nga pala blerëse. Për më tepër, nëse pagesa, në këtë rast do të ishte bërë nga pala shitëse, marrë në konsideratë dhe sa analizuar më sipër, do të duhej të shërbente si fakt hetimi për Komisionin, pasi vlera reale e shitjes (përfitimit monetar neto për shitësit) do të rezultonte akoma edhe më e ulët nga sa parashikohet në kontratën e shitblerjes.

(iii) *Veprime në dukje fiktive*

6.3 Diferenca midis çmimit të shitjes së kësaj pasurie sipas udhëzimit nr. 9/2008 dhe çmimit të përcaktuar në kontratë midis palëve, rreth 40% më lirë, duhej të shërbente si indicie për Komisionin, për të hetuar në mënyrë më të plotë në drejtim të veprimeve fiktive në dukje, me

<sup>6</sup> Konvertuar çmimi në kontratë, që është 53.000 euro.

qëllim për të mbuluar pamundësinë financiare nga burime të ligjshme të subjektit të rivlerësimit, për të blerë këtë pasuri me çmimin real të saj.

(iv) *Vlerësimit të burimit të ligjshëm të të ardhurave të deklaruara nga kontrata e shitjes e datës \*\*\*.10.2010, në shumën 1.400.000 lekë*

6.4 Në lidhje me burimin e të ardhurave të deklaruara nga shitja e aseteve të aktivitetit privat të personit të lidhur, znj. \*\*\*. \*\*\*, bashkëshortja e subjektit, në shumën 1.400.000 lekë, e cila ka shërbyer si një nga burimet e krijimit të depozitës bankare prej 53.000 euro<sup>7</sup>, në emër të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortes së tij, rezulton se Komisioni nuk ka hetuar në mënyrë ezauruese mbi burimin e ligjshëm të krijimit të saj.

6.5 Nga aktet në dosje rezulton se shuma 1.400.000 lekë rrjedh nga kontrata e shitjes e datës \*\*\*.10.2010, me palë shitëse, znj. \*\*\*. \*\*\*, dhe detyrimet tatimore për këtë të ardhur janë paguar me mandat-pagesën e datës \*\*\*.5.2019, pranë \*\*\* Bank. Në vlerësimin e Komisionerit Publik, mangësitë e hetimit të Komisionit për këtë të ardhur lidhen me sa vijon:

6.6 Rezulton se personi i lidhur, znj. \*\*\*. \*\*\*, ka qenë ortakë dhe administratore e vetme e një aktiviteti privat, regjistruar si person juridik “\*\*\*\*” sh.p.k., me vendimin nr. \*\*\*, datë \*\*\*.6.2004, të Gjykatës së Shkallës së Parë, Tiranë, me seli dhe veprimtari në Fier.

6.7 Sipas përmbajtjes së kontratës së shitjes, datë \*\*\*.10.2010, znj. \*\*\*. \*\*\*, në cilësinë e shitëses, dhe shtetasi \*\*\*. \*\*\*, në cilësinë e blerësit, kanë përcaktuar se: “... në marrëveshje mes tyre, pala shitëse i shet palës blerëse, në kushtet që ka mbyllur aktivitetin e saj si administratore e kopshtit..., i shet palës blerëse mjete me natyrë si vijon...”. Përpara nënshkrimit të kësaj kontrate, rezulton se me vendimin nr. \*\*\*, datë \*\*\*.2.2010, të Asamblesë së Ortakut të Vetëm, është vendosur mbyllja e shoqërisë dhe caktimi i likuidatorit, znj. \*\*\*. \*\*\*<sup>8</sup>, duke kaluar me status: “Shoqëri në likuidim e sipër”, pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (referuar si QKB), prej datës \*\*\*.2.2010<sup>9</sup>.

6.8 Në analizë të rrethanave dhe fakteve të mësipërme, në raport me përcaktimet e ligjit nr. 9901/2008, “Për shoqëritë tregtare”, të ndryshuar, ligjshmëria dhe efektet juridike që kanë rrjedhur nga veprimi juridik, kontrata e shitjes së aseteve të shoqërisë, të datës \*\*\*.10.2010, vihen në diskutim, duke ndikuar kështu dhe në vlerësimin mbi ligjshmërinë e të ardhurave që ka sjellë kjo kontratë. Sipas neneve 196/1 dhe 197/1, të ligjit nr. 9901/2008, “Për shoqëritë tregtare”, të ndryshuar, ndër të tjera, përcaktohet se: “*Likuiduesi merr përsipër të drejtat dhe detyrimet e administratorëve nga data e emërimit të tij*” dhe se “*Detyra e likuiduesve është mbyllja e të gjitha veprimeve të shoqërisë, mbledhja e kredive të paarkëtuara dhe e kontributeve të pashlyera, shitja e pasurive të shoqërisë dhe shlyerja e kreditorëve...*”.

6.9 Sa më sipër konfirmohet edhe nga përgjigjja e Drejtorisë së Përgjithshme e Tatimeve, në dy shkresat e drejtuara Komisionit<sup>10</sup>, e cila, ndër të tjera, pasi referon ligjin nr. 9901/2008, “Për shoqëritë tregtare”, të ndryshuar, parashtron se: “... *Individi, ortaku i shoqërisë nuk mund të shesë në emër të tij asetet, të cilat janë pronë e shoqërisë*”.

<sup>7</sup> Kjo depozitë bankare ka shërbyer për blerjen e pasurisë “*Apartament banimi 63 m<sup>2</sup>*”.

<sup>8</sup> Vendimmarrje në përputhje me dispozitat ligjore të ligjit për shoqëritë tregtare dhe nenet 17 e në vijim të statutit të kësaj shoqërie.

<sup>9</sup> Raporti i likuidimit të shoqërisë, i përgatitur nga likuidatori i caktuar, pasi ka nxjerrë si pasive të shoqërisë vetëm kapitalin themeltar të krijimit, prej 100.000 lekë, rezulton të jetë miratuar me vendim të Asamblesë së Ortakëve (të vetëm), më datë \*\*\*.2.2019, duke shfuqizuar edhe mandatin e likuidatorit. Ky fakt është reflektuar edhe pranë QKB-së, ku nga status: “Shoqëri në likuidim e sipër”, ka kaluar me status: Shoqëri e “çregjistruar”, me datë efektive: \*\*\*.4.2019.

<sup>10</sup> Shkresa me nr. \*\*\*/\*\*\* prot., datë \*\*\*.6.2019 dhe shkresa nr. \*\*\*/\*\*\* prot., datë \*\*\*.7.2019.

6.10 Në vështrim të sa më sipër, duket se kontrata e shitjes së aseteve të biznesit privat nga ana e bashkëshortes së subjektit është bërë në kapërcim të ligjit, pasi prej datës \*\*.2.2010, në cilësinë e administratores, ortakes së vetme, e aq më pak në cilësinë e individit, personi i lidhur, znj. \*\*. \*\*, nuk ka pasur të drejtë të disponojë dhe të shesë asetet e personit juridik, për më tepër asetet e një shoqërie në likuidim e sipër.

6.11 Rezulton se gjatë hetimit administrativ, me mandatpagesën e datës \*\*.5.2019, bashkëshortja e subjektit ka paguar shumën e detyrimeve tatimore mbi të ardhurat e realizuara nga shitja e aseteve të biznesit privat, në shumën 210.000 lekë.

6.12 Në vlerësimin e Komisionerit Publik, bazuar në jurisprudencën e Kolegjit, në funksion të shkaqeve të ankimit, ky i fundit (Kolegji) duhet të vlerësojë nëse të ardhurat në shumën 1.400.000 lekë, plotësojnë përcaktimet e parashikuara në nenin D të aneksit të Kushtetutës dhe ligjin nr. 84/2016, për t'u konsideruar si të ardhura të ligjshme, nga një burim i ligjshëm.

## *7. Mungesë hetimi mbi pamjaftueshmërinë për të mbuluar me burime të ligjshme shpenzimet dhe kursimet e deklaruar ndë vite*

7.1 Komisioneri Publik, në konsideratë të shkaqeve të ankimit<sup>11</sup>, çmon se në gjendjen që janë aktet e administruara, është e nevojshme që Kolegji të rikryejë analizën financiare mbi vlerësimin e mundësive të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të, për të mbuluar me burime të ligjshme nga të ardhura të ligjshme, shpenzimet dhe pasuritë e deklaruar për të gjithë periudhën e deklarimit.

7.2 Në lidhje me nevojën e hetimit për kontrollin e kriterit të pasurisë, Komisioneri Publik vlerëson se është i nevojshëm:

7.2.1 Administrimi i plotë i praktikës dokumentare për pasurinë nr. \*\*\*/\*\*+\*\*-\*\*, vol. \*\*, faqe \*\*, zona kadastrale \*\*, për pasurinë e llojit apartament me sipërfaqe 102.6 m<sup>2</sup>, në emër të subjektit të rivlerësimit, z. Petrit Çano, duke iu drejtuar Agjencisë së Kadastrës Shtetërore.

7.2.2 Administrimi i informacionit nga organi i Prokurorisë, nëse subjekti ka hetuar apo kryer veprime procedurale në çështje që lidhen me palën shitëse, z. \*\* \*\*\*, në Prokuroritë Berat, Vlorë, Lushnjë dhe Krujë.

7.2.3 Administrimi i plotë nga Agjencia e Kadastrës Shtetërore, të praktikës dokumentare për pasurinë nr. \*\*\*/\*\*+\*\*-\*\*, vol. \*\*, faqe \*\*, zona kadastrale \*\*, për pasurinë e llojit apartament 63 m<sup>2</sup>, në emër të znj. \*\*. \*\*, Tiranë.

7.2.4 Administrimi i informacionit nga organi i Prokurorisë, nëse subjekti ka hetuar apo kryer veprime procedurale në çështje që lidhen me palën shitëse znj. \*\* \*\*\* (\*\*\*), \*\* \*\*\* (\*\*\*), \*\* \*\*\* (\*\*\*), \*\* \*\*\* (\*\*\*), në Prokuroritë Berat, Vlorë, Lushnjë dhe Krujë.

7.2.5 Analizimi nga ana e Kolegjit i mundësisë financiare të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të, si dhe rivlerësimi i zërave përkatës të deklaruar, të përdorur si burim krijimi të

---

<sup>11</sup> Sikundër trajtuar gjerësisht në ankim mbi pamjaftueshmëritë e konstatuara për vitet 2005 dhe 2011.

pasurive të sipërcituara, për të mbuluar me burime të ligjshme shpenzimet dhe depozitimet në sistemin bankar.

### **III. Për kontrollin e kriterit të aftësisë profesionale**

8.1 Në lidhje me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, konstatohet se që prej vitit 2000, ai ushtron funksionet e drejtuesit në organin e Prokurorisë së juridiksionit të përgjithshëm pranë Gjykatave të Shkallës së Parë Vlorë (2000-2008), Lushnjë (2008-2015) dhe, prej vitit 2015, vijon aktualisht si drejtues i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Krujë.

8.2 Nga dhjetori i vitit 2015, subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Krujë, deri në miratimin e ndryshimeve të K. Pr. P. me ligjin nr. 35/2017, ka qenë në cilësinë e prokurorit epror, me kompetenca kontrolluese ndaj veprimtarisë së prokurorëve më të ulët të asaj Prokurorie, në ushtrimin e detyrës.

8.3 Pas ndryshimeve të ndodhura me ligjin nr. 35/2017 në K. Pr. P. dhe miratimin e ligjit nr. 97/2016, subjekti i rivlerësimit, bazuar në dispozitat e Kreut V të ligjit nr. 97/2016, në ndryshim të kompetencave të prokurorit epror, drejtuesit të Prokurorisë i njihen kompetenca në lidhje me: (i) drejtimin e Prokurorisë; (ii) ushtrimin e ndjekjes penale; (iii) nxjerrjen e udhëzimeve të përgjithshme të detyrueshme dhe (iv) nxjerrjen e udhëzimeve jo të detyrueshme për çështje konkrete.

8.4 Ndërkohë, në zbatim të dispozitave të K. Pr. P., ligjit nr. 9331/1998, të ndryshuar, ligjit nr. 8328/1998, ligjit nr. 81/2020, subjekti i rivlerësimit është në cilësinë e drejtuesit të zyrës të organit të Prokurorisë, që përveç kompetencës që i njej juridiksioni gjyqësor për hetimin e veprave penale të parashikuara nga Kodi Penal, është përgjegjës dhe për mbrojtjen e interesit publik gjatë fazës së ekzekutimit të dënimeve me burgim, të caktuara nga vendimet penale, të dhëna nga gjykatat shqiptare ose ato të autoriteteve gjyqësore ndërkombëtare, që janë njohur nga ana e gjykatave shqiptare në zbatim të legjislacionit vendas dhe konventave ndërkombëtare, të nënshkruara nga ana e Republikës së Shqipërisë.

8.5 Rezulton se në kompetencën tokësore të Gjykatës së Shkallës së Parë, Krujë (neni 470 i K. Pr. P.), pranë së cilës funksionon zyra e Prokurorisë që drejton subjekti i rivlerësimit, kanë vendndodhjen dy institucione të ekzekutimit të vendimeve penale, institucioni i veçantë Krujë dhe ai i Fushë-Krujës, ku brenda këtij të fundit funksionojnë regjimi i sigurisë së lartë dhe ai i sigurisë së zakonshme, për efekt të ekzekutimit të vendimeve me burgim.

8.6 Ankimi i Komisionerit Publik kundër vendimit nr.183/2019, të Komisionit, është ushtruar për të tria kriteret e rivlerësimit. Gjatë kohës që ky ankim i Komisionerit Publik pritej të shqyrtohej në Kolegj, është konstatuar se në muajin janar 2021, kryesisht ana e ILD-së, është iniciuar procedimi disiplinor për një nga magjistratët/prokurorët e Prokurorisë, që drejtohet nga ana e subjektit të rivlerësimit. ILD-ja, në përfundim të procesit hetimor, ka paraqitur pranë KLP-së kërkesë për marrjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra. KLP, me vendimin nr. \*\*\*, datë \*\*\*.3.2021, ka vendosur shkarkimin nga detyra të magjistratit/prokuror \*\*\*.\*\*\*., për kryerjen e shkeljeve disiplinore në të paktën katër gjykime të kërkesave të paraqitura nga të dënuarit gjatë fazës së ekzekutimit të vendimeve penale.

8.7 Nga përmbajtja e këtij vendimi, të konsultuar në faqen zyrtare të KLP-së, rezulton se një nga shkeljet disiplinore të kryera nga ana e magjistratit në fjalë, që ka shërbyer shkarkimin e tij nga

detyra, është mosushtrimi i ankimit në Gjykatën e Apelit, në të katër çështjet gjyqësore, të cilat janë referuar për procedim disiplinor nga ana e ILD-së.

8.8 Po t'i referohemi përmbajtjes së vendimit të KLP-së, shkeljet disiplinore dhe mospërmbushja e pajustificuar e funksioneve të prokurorit gjatë gjykimit, ka qenë një situatë e përsëritur në punën e magjistratit konkret, i cili ushtronte detyrën në Prokurorinë që drejtohet nga subjekti i rivlerësimit.

8.9 Përveç rasteve të referuar nga ana e ILD-së, referuar përmbajtjes së vendimit nr.\*\*\*, datë \*\*\*.3.2021, për periudhën 1.1.2017 - 1.7.2020, magjistrati/prokuror konkret, që ushtronte funksionet në Prokurorinë e drejtuar nga subjekti i rivlerësimit, është konstatuar në shkelje të ligjit, duke mos ushtruar ankim në shkelje të ligjit për 4 vendime të dhëna mbi kërkesat e të dënuarve me objekt: *“Llogaritje kohe paraburgimi”* dhe 7 vendime me objekte kërkesë nga ana e të dënuarit: *“Përfitim nga amnistia”*. KLP-ja ka vlerësuar në këtë vendim se standardet e gabuara të qëndrimeve pasive të këtij magjistrati/prokuror, ndaj vendimeve gjyqësore, mund të shërbejnë si praktikë edhe për shumë të dënuar të tjerë me rrezikshmëri shumë të lartë shoqërore, për të pretenduar në kundërshtim me ligjin në fuqi për lirimin e tyre para kohe, me kusht përfitim amnistie, llogaritje kohe paraburgimi gjatë periudhës së qenies i dënuar apo aplikime alternative të dënimit.

8.10 Në këto rrethana, në referencë të ushtrimit të kompetencave të Prokurorisë në fazën e ekzekutimit të vendimeve penale, sikundër u tha më lart, subjekti i rivlerësimit, deri në hyrjen në fuqi të ligjit nr. 35/2017, *“Për disa shtesa dhe ndryshime në Kodin e Procedurës Penale”*, në cilësinë e drejtuesit të Prokurorisë, ka pasur kompetencat e prokurorit epror, për të reformuar çdo vendimmarrje që konsiderohej në kundërshtim me ligjin, kryer nga prokurori më i ulët.

8.11 Ndërkohë me hyrjen në fuqi të ndryshimeve në K. Pr. P. dhe miratimin e ligjit nr. 97/2016, drejtuesi i Prokurorisë, ndër të tjera, ka si kompetencë: (i) organizon shpërndarjen e çështjeve prokurorëve<sup>12</sup>; (ii) të mbikëqyrë disiplinën në punë të prokurorëve dhe i bën kërkesë ILD-së për fillimin e inspektimit për shkelje disiplinore të magjistratëve<sup>13</sup>; (iii) kërkon informacion për ecurinë dhe përfundimin e procedimeve dhe, nëse është e nevojshme, udhëzon me shkrim, sipas këtij ligji<sup>14</sup>; (iv) nxjerr udhëzime të përgjithshme detyruese<sup>15</sup>; (v) nxjerr udhëzime jo të detyrueshme për çështje konkrete<sup>16</sup>.

8.12 Duke marr shkas nga këto situata ligjore të parashtruara më lart, si pjesë e vlerësimit të kriterit të aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit, në cilësinë e drejtuesit të Prokurorisë, Komisioneri Publik parashtron kërkesën për hetim si më poshtë:

8.12.1 Administrimin e informacionit nga ana e Gjykatës së Shkallës së Parë, Krujë, në lidhje me numrin e kërkesave të gjykuara (për të cilat është dhënë vendim mbi kërkimin e kërkesit/të dënuarit) gjatë fazës së ekzekutimit të vendimeve penale dhe vendimeve përkatëse me objekt: (i.i) qëndrimi në shtëpi (neni 59/a i K. Penal); (i.ii) lirim para kohe me kusht (neni 64 dhe 65 i K. Penal), (i.iii) llogaritje e paraburgimit, (i.iv) njohje amnistie; të shqyrtuara me prezencë të prokurorit pranë kësaj gjykate, në periudhën 1.1.2016 - aktualisht.

<sup>12</sup> Shkronja “c”, neni 42 i ligjit nr. 97/2016.

<sup>13</sup> Shkronja “dh”, neni 42, po aty.

<sup>14</sup> Shkronja “b”, neni 43, po aty.

<sup>15</sup> Pika 1, 2, 4, neni 46, po aty.

<sup>16</sup> Shkronja “c”, pika 1, pikat 2, 3, 4 dhe 6, neni 48, po aty.



8.12.2 Administrimin e informacionit nga ana e Gjykatës së Shkallës së Parë, Krujë, në lidhje me numrin e ankimeve të paraqitura nga ana e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Krujë, për vendimet e dhëna nga kjo gjykatë, për kërkesa të paraqitura gjatë fazës së ekzekutimit të vendimeve penale dhe vendimmarrjen përkatëse të Gjykatës së Apelit.

8.12.3 Administrimin e informacionit nga ana e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Krujë, në lidhje me ekzistencën eventuale të udhëzimeve të hartuara nga ana e drejtuesit të Prokurorisë, sipas shkronjës “c”, të nenit 43, pikave 1, 2, 4 të nenit 46 dhe shkronjës “c”, pika 1, pikat 2, 3, 4 dhe 6, neni 48, në lidhje me ushtrimin e funksioneve të Prokurorisë gjatë fazës së gjyqimit të kërkesave të paraqitura nga ana e të dënuarve, në fazën e ekzekutimit të vendimeve penale, duke administruar për efekt të këtij procesi, kopje të këtyre akteve.

8.12.4 Administrimin e informacionit nga ana e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Krujë, për shpërndarjen te prokurorët të çështjeve me objekt kërkesat e të dënuarve gjatë fazës së ekzekutimit të vendimeve penale me burgim.

**KOMISIONERI PUBLIK**  
**Florian BALLHYSA**